



Kjo është
SFIDA
ime...

Në kuadër të projektit: “Një qasje tërësore për të adresuar nxënësin në rrezik braktisje të shkollës në Tiranë, Korçë, Berat and Durës” zbatuar nga Albanina Social Services Association me bashkëpunim me MASR & ASCAP dhe mbështetur nga Unicef Albania.
@2019 Konceptoi: Livia Nano, Anila Salla, Anxhela Zeqiraj

Printuar dhe lidhur:  *printAL*
digital print shop
Bulevardi “Zogu i Parë”, Qendra Tregtare Tirana, Tiranë
E-mail: printal2013@gmail.com, Tel: 0676703222 / 0672847201

Ja se si shprehet një mësuese kur pyetjet: **Për çfarë jeni krenarë ju në lidhje me punën që është bërë me nxënësin në rrezik braktisje të shkollës?**

Krenarë na bën fakti që Albani vjen çdo ditë në shkollë. Mjafton ta shohësh atë duke qeshur me shokët, duke luajtur me ta, duke punuar e duke u shpallur edhe shtëpi në shumë raste. Tashmë, Albani është kthyer në një model motivimi për shumë fëmijë të tjerë në pozitë të tij. Krenarë gjithashtu jemi edhe për ecurinë e tij në nivel akademik, por edhe në atë psikosocial.

4 *Projekti në shifra.*

- 20 shkolla të vendit dhe përkatësisht: në Tiranë (Androkli Kostallari, Ardian Klosi, Qazim Turdiu, Mihal Grameno, Kushtrimi I Lirisë, Osman Myderizi) në Korçë (Naum Veqilharxhi, Ismail Qemali, Sotir Gura, Pandeli Cale, Asdreni); Berat (1 Maji, Thimi Tani, Shyqyri Lakra, Zihni Toska, Ajet Xhindole) dhe Durrës (Shkolla e Re, Qemal Mici, SHMB Kullë, Abedin Dino) kanë qenë pjesë e pilotimit të ndërhyrjeve më efektive për të parandaluar dhe adresuar rrezikun e braktisjes së shkollës.

- Janë ngritur kapacitetet e 300 mësuesve dhe aktorëve të tjerë të shkollës në lidhje me Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm për të identifikuar dhe adresuar që herët nxënësit në rrezik braktisje.

- 200 mësues, psikologë shkollë dhe drejtorë janë trajnuar në lidhje me zhvillimin e shprehive socio-emocionale duke synuar kështu rritjen e reziliencës së fëmijëve vulnerabël dhe në rrezik braktisje të shkollës.

- 168 mësues dhe drejtues shkollë janë trajnuar në lidhje me krijimin e marrëdhënieve të mira dhe përfshirjen e prindërve në shkollë.

- 200 mësues janë trajnuar në lidhje me hapat e hartimit & zbatimit të plani veprimit dhe fonde të vogla i janë kaluar 20 shkollave për të realizuar aktivitete në bazë shkollë për të adresuar fëmijët në rrezik braktisje.

Projekti në shifra 5


- 20 shkollave i janë ofruar 2 module praktike me fletë pune dhe instrumenta për të zhvilluar shprehitë socio-emocionale të nxënësve & për të forcuar marrëdhëniet prindër-shkollë.
- 200 mësues të shkollave të tjera jo të përfshira në projekt kanë marrë informacion në lidhje me adresimin e nxënësve në rrezik braktisje nëpërmjet kolegë të tyre tyre (peer-training) të trajnuar më parë.
- 24 takime rajonale me qëllim ndarjen e eksperiencave dhe sfidave, diskutimin e mësimëve të nxjerra janë realizuar përgjatë vitit;



Pikturë e realizuar nga fëmijët e shkollës "A. Kostallari"


6 Projekti në shifra

Nga grafiku më poshtë vihet re se ka një reduktim të përqindjes së fëmijëve të identifikuar në rrezik të lartë dhe të moderuar në fund, pas ndërhyrjeve në 20 shkollat.



Ndërhyrjet e realizuara gjatë vitit akademik 2018 - 2019 kanë ndikuar në përmirësimin e situatës së nxënësve në rrezik braktisje në këto tre fusha kryesore:

1. Performanca & mbarëvajtja akademike
2. Sjellja
3. Frekuentimi i shkollës



Reflektime dhe mësim të nxjerra

Çdo fëmijë është unik! Çdo situatë është unike!

Megjithëse nuk ka receta të cilat mund të zbatohen me përpikmëri në të gjitha rastet dhe kontekstet ka disa modele të mira pune, apo mësimet e nxjerra nga puna e drejtpërdrejtë me fëmijët në rrezik braktisje të shkollës.

Bazuar në eksperiencën e deritanishme të 20 shkollave, në mënyrë që ndërhyrjet në shkollë për të përmirësuar frekuentimin dhe adresuar fëmijët në rrezik braktisje të jenë efektive kërkohet një ndryshim apo një kalim:

8 Reflektime dhe mësim të nxjerra

NGA

1. Nga fokusimi vetëm tek ata nxënës që kanë rrezik të lartë braktisje ose tek ata të cilët nuk e frekuentojnë fare shkollën.




TEK

1. Tek fokusimi tek të gjithë nxënësit – duke qenë vigjilent edhe për ata të cilët kanë nivel të mesëm apo të ulët të rrezikut për braktisjes së shkollës.



NGA

2. Nga një i kuptuar i cekët apo tepër i ngushtë i arsyeve të rrezikut për braktisje të shkollës të tilla si:



TEK

2. Tek zgjerim dhe një i kuptuar më i thellë i arsyeve të tjera që mund të ndikojnë në rritjen e shanseve për të braktisur shkollën të tilla si:



10 Reflektime dhe mësim të nxjerra

NGA

3. Nga një qasje e fokusuar vetëm tek gjërat që nuk shkojnë, tek problemet, vështirësitë apo deficitet kur flasim për nxënësit në rrezik braktisje.




TEK

3. Tek një qasje e fokusuar tek pikat e forta. Është e nevojshme që aq mirë sa jemi në gjendje të identifikojmë vështirësitë dhe problemet që kanë nxënësit – të jemi në gjendje të identifikojmë edhe talentet, pikat e forta, burimet apo mbështetjet për të cilat ata kanë nevojë.



NGA

4. Nga përpjekjet vetëm për të adresuar apo trajtuar problemin e shfaqur.



TEK


4. Tek përpjekjet serioze edhe për ta parandaluar problemin si edhe për ti ndihmuar nxënësit të rriten dhe zhvillohen pozitivisht.



12 Reflektime dhe mësim të nxjerra


NGA

5. Nga perceptimi i zgjidhjes kryesisht jashtë shkolle – sepse shkolla vet perceptohet se ka pak mundësi & burime për të adresuar fëmijët në rrezik braktisje.



TEK

5. Tek ndërmarrja e një rol më aktiv i të gjithë aktorëve të shkollës dhe marrje e më tepër e përgjegjësive në këtë drejtim.



NGA

6. Nga të punuarit në mënyrë individuale dhe të izoluar nga njëri-tjetri.



TEK

6. Tek i punuari në ekip brenda shkollës, ku edhe nxënësit, përveç mësuesve, perceptohen si burime që mund të ndihmojnë dhe kontribuojnë.



14 Reflektime dhe mësim të nxjerra

NGA

7. Nga një qendrim i pashpresë dhe i dorëzuar se prindërit nuk marrin pjesë dhe nuk angazhohen në shkollimin e fëmijës në rrezik braktisje.

TEK

7. Në një angazhim aktiv dhe të vendosur për të krijuar marrëdhënie të mira me prindërit dhe për ti bërë ata pjesë aktive e shkollës edhe pse e vështirë.

Nëpërmjet një komunikimi efektiv me prindërit – mësuesit mund të kenë një impakt më të madh në suksesin e nxënësit. Duke patur prindërit në krahë – mësuesit mundet të menaxhojnë në mënyrë më efektive të gjitha problemet me natyrë akademike dhe sjellore të nxënësve;

“Kur shkolla, familja dhe komuniteti punojnë së bashku për të mbështetur fëmijët, ata kanë më tepër gjasa të të dalin më mirë në shkollë, ta frekuentojnë shkollën rregullisht dhe mbi të gjitha ta pëlqejnë shkollën”

NGA

8. Nga perceptimi se punën duhet ta bëjnë vetëm profesionistët (p.sh. psikologu i shkollës, punonjësi social) apo mësuesja kujdestare që ka në klasë nxënësin në vështirësi apo në rrezik braktisje.



TEK

8. Tek një angazhim i përbashkët, tek krijimi i një atmosfere shkollore ku të gjithë të ndejnë përgjegjësinë për të bërë diçka për të kontribuar edhe pse nxënësi nuk është në klasën e tij/saj.




16 Reflektime dhe mësim të nxjerra

NGA

9. Nga konceptimi dhe realizimi i një pune vetëm në nivel individual me nxënësit në rrezik braktisje.

TEK

9. Tek puna me tre nivele ku nxënësi në rrezik do të përfitoj si nga ndërhyrjet në nivel universal me fokus të gjithë shkollën; ashtu edhe nga ndërhyrjet e targetuara që kanë në fokus vetëm një grup nxënësish ashtu edhe nga ndërhyrjet në nivel individual kur është e nevojshme.




NGA

10. Nga një punë afatshkurtër dhe fragmen-
tarizuar në lidhje me nxënësit në rrezik braktisje
të shkollës apo që nuk frekuentojnë në mënyrë të
rregullt.

TEK

10. Në një punë afatgjatë dhe të mirë
organizuar sipas gjashtë hapave më poshtë
të Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm².



18 Reflektime dhe mësim të nxjerra

NGA

11. Nga përpjekjet për të ofruar vetëm një gamë të ngushtë strategjish/ndërhyrjesh për të adresuar nxënësit në rrezik braktisje të tilla si:

- Ndihmë financiare/mbështetje materiale për familjet dhe fëmijët;
- Referime në qendra sociale apo minibashki/bashki;
- Këshillime psikologjike individuale për nxënësit me probleme;
- Ndihma ushqimore;

TEK

11. Tek zgjerimi i gamës së strategjive dhe ndërhyrjeve efektive të tilla si:

- Aktivitete që synojnë ndërtimin e shprehive socio-emocionale të nxënësve, këto të integruara nga mësueset gjatë orëve edukative/kujdestarisë apo aktiviteteve ekstrakurrikulare;
- Aktivitete që krijojnë një atmosferë pozitive në shkollë;
- Takime, ëorkshope të vazhdueshme me prindërit për t'u përfshirë më tepër në shkollë;
- Mbështetje ekstra për mësimet dhe detyrat e shtëpisë së nxënësve;
- Krijimi i grupeve të patronazhit – ku fëmijët ndihmojnë fëmijët;
- Aktivitete ekstrakurrikulare, klube arti, sporti etj.;
- Ofrimi i nxënëve me mundësi për të marrë pjesë, për të kontribuar në shkollë dhe jashtë saj si edhe për të qenë lider;
- Dokumentimi i rasteve të suksesit, ndarja me fëmijët e tjerë – në mënyrë që këto të shërbejnë si modele frymëzuese për tu ndjekur dhe për të nxjerrë mësim;
- Komunikimi i mesazheve mbi rëndësinë e frekuentimit të shkollës nëpërmjet formave të ndryshme të artit (pikturë, psikodramë, muzikë etj.);
- Trajtime për mësuesit në lidhje me rëndësinë e të mësuarit socio-emocional dhe format alternative se si ata mund ti përfshijnë këto komponentë në aktivitetet kurrikulare dhe ekstrakurrikulare;
- Trajtime për mësuesit në për ndërtimin e marrëdhënie të mira dhe përmirësimin e komunikimit me prindërit;
- Trajtime më mësuesit në lidhje me rëndësinë e ndërhyrjeve në tre nivele dhe zbatimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm të braktisjes shkollore;
- Krijimi i rrjeteve të mësuesve dhe realizimi i takimeve në vazhdimësi për të ndarë sfidat & mënyrat se si ata i kanë kapërcyer apo adresuar ato;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi i punës me aktorë të ndryshëm jashtë shkolle.

NJË RAST SUKSESI¹: UNË TANI VIJ ME QEJF NË SHKOLLË

1.1 *Situata familjare*

Albani është një nxënës 10-vjeçar që studion në klasën e tretë. Vjen nga një familje rome me nivel të ulët arsimor, por edhe me probleme të tjera sociale si papunësia, lëvizja demografike, strehimi, shëndetësia, pranimi nga shoqëria, si edhe probleme të tjera që shqetësojnë këtë komunitet.

Ndonëse është një fëmijë inteligjent, nuk kishte dëshirë të ndiqte shkollën. I mungonte dëshira për shumë arsye, por themelorja ishte mënjanimi i shoqërisë. Në mënyrë të vazhdueshme kthehej në shtëpi i revoltuar nga shokët dhe mësuesja, jo rrallëherë, nga “paaftësia” e tij për t’u bërë ballë të gjitha situatave që i lindnin, kështu që të nesërmen zgjidhte të mos shkonte më. Vazhdonte disa ditë kështu, pastaj rikthehej. Përsëritej pothuaj e njëjta histori dhe ai sërish mungonte, me ditë, me javë të tëra...

Megjithatë, përtej të gjitha rrethanave, jo aq të thjeshta për një fëmijë emotiv si ai, prindërit e Albanit nuk kanë dashur që ai ta braktisë shkollën, përkundrazi. Për ta, Albani dhe motra e tij duhet të ndiqnin shkollën me çdo kusht, sado e lartë të ishte kjo kosto për ta. Dhe kështu ndodhi.

¹Rast sukcesi nga shkolla Ardian Klosi, Tiranë. Emri i fëmijës i përdorur në këtë përshkrim rasti nuk është ai i vërteti.

1.2 Performanca në shkollë:

Albani u prezantua fillimisht në shkollën “Ardian Klosi” si një nxënës i ardhur nga një shkollë tjetër, pa specifikuar arsyet e largimit. Ra në sy si fëmijë i ndrojtur, që shihte me dyshim gjithçka, edhe veprimet e shokëve në klasë dhe jashtë saj. I dukej vetja ndryshe dhe jo i barabartë me ta. Nguronte të tregonte aftësitë e tij në mësim, në situata të ndryshme problemore, por gjithashtu refuzonte të shprehte talentin e tij në vizatim, në këngë e aktivitete të tjera që organizoheshin në shkollë. Por dëshira nuk i mungonte, kështu që dalëngadalë, duke fituar “terren” në klasë dhe duke parë që të gjithë fëmijët nisën ta përkrahin, situata për të ndryshoi.

Ndryshe nga më parë, iu shtua dëshira për të ardhur çdo ditë në shkollë, për të kaluar kohë me shokët dhe shoqet, për të punuar më shumë me mësuesen, për të bërë detyra, si edhe për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme jashtëshkollore. Në krahasim me disa muaj më parë, tani mëngjeset për Albanin ishin të tjera. Ishte ai që i zgjonte prindërit në mëngjes për të shkuar në shkollë. Gjithçka pas këtyre veprimeve të tij, u përkthye dalëngadalë në performancë shumë të mirë, si në ecurinë e tij akademike, ashtu edhe në spektrin social. Siç tregon i ati, në një prej takimeve me stafin në shkollë:

Albani jo vetëm ishte bërë zilja e tyre e mëngjesit, por njëkohësisht, këmbëngulte që edhe prindërit të ishin pjesëmarrës në aktivitetet në të cilat ai bëhej pjesë në shkollë.

22 *Një rast sukcesi*

1.3 *Sjellja*

Sapo erdhi në shkollë, Albani kishte probleme edhe me sjelljen, shfaqte herë pas here shpërthime dhe nuk arrinte gjithmonë t'i menaxhonte. Mësuesja kujdestare, me shumë durim, përpigjej të kuptonte shkaqet e luhatjeve të këtyre sjelljeve, t'i menaxhonte ato dhe të njëjtën gjë kërkoi nga Albani dhe shokët e tij të klasës. Duke vepruar me qetësi ndaj çdo problemati e që lindte, Albani nisi të kuptojë se shokët e klasës janë si ai, por edhe ai është si të gjithë ata.

Sot, nëse sjellja e Albanit mund të përkufizohet vetëm me dy fjalë, do të ishte “shumë e mirë”. Por kaq nuk mjafton. Sepse Albani, gjatë këtyre muajve që ka ndjekur shkollën në “Ardian Klosi”, kuptoi se edhe mjedisi social, raporti me shokët dhe shoqet, është shumë i rëndësishëm për ta lidhur atë më shumë me shkollën, që të dojë të vijë çdo ditë aty, si edhe të krijojë terren për ta pasur bashkudhëtare për shumë vite (pse jo) këtë shoqëri që ka krijuar në shkollë.

1.4 *Marrëdhëniet me shokët*

Në fillim , shokët ishin të huaj për të, ashtu siç ishte, deri diku, edhe Albani për ta. Sa herë e ftonin të bëhej pjesë e lojërave apo aktiviteteve të ndryshme në klasë, ai nguronte, por e shprehte hapur interesin dhe dëshirën për të qenë pjesë e lojës, pikturës, këngës, e gjithçkaje të bukur që organizohej në klasë e jashtë saj.

Dalëngadalë, pasi u miqësua me shokët, nisi të kuptonte se pothuajse të gjithë nuk e shikonin si “të ri” në klasë, por si një shok që kishte qenë gjithmonë aty. Herë pas here, mësuesja dhe fëmijët e tjerë e nxitnin të shprehte dëshirat që kishte dhe të tregonte aftësitë e tij. Shumë shpejt, ngurimi ndaj situatave të ndryshme iu zbeh, derisa e ndjeu veten të barabartë, madje ndonjëherë edhe mjaft i zoti për të triumfuar.

Sot, Albani ka nisur të kuptojë se shokët dhe shoqet e shkollës mund t'i ketë me vete për vite të tëra, ka një raport shumë të mirë me ta, luan dhe argëtohet, punon me ta, kërkon ndihmë sa herë i nevojitet, por nuk nguron edhe të tregojë se është i barabartë me ta edhe në “ndeshje” të ndryshme, aktivitete sportive etj. Nga shokët, Albani ka mësuar se ambicia e mirë është një ndjesi që të nxit të shkosh më lart. Por edhe shokët e klasës kanë mësuar shumë nga Albani, ndaj edhe duan ta kenë pranë sa herë kanë aktivitete të ndryshme në shkollë. E kanë një “lojtar” të fortë që u jep zemër dhe siguri për fitoren.

2. Kujt i dedikohet sukcesi i arritur deri tani?

- Së pari, vullnetit të Albanit, dëshirës dhe këmbënguljes së tij për ta vijuar shkollën, pavarësisht problemeve.
- Punës me shumë përkushtim të mësueses së tij – një faktor mjaft i rëndësishëm që Albani vinte me gejft në shkollë.
- Shokëve të tij të klasës, që e mirëpritën dhe e mbajtën afër, e ndihmuan dhe vazhdojnë ta bëjnë sa herë ai ka nevojë.
- Prindërve, që pavarësisht vështirësive dhe kushteve jo fort të favorshme, nuk ia ndërprejnë Albanit dëshirën për të ardhur në shkollë.
- Mundësive të tjera (pjesëmarrja në klube) që i ofroi shkolla për ta mbajtur afër e për të mos e lënë ta braktisë atë.
- Punës së përbashkët dhe të mirëkoordinuar nga ekipi i shkollës, në kuadër të Sistemit të Paralajmërim-it të Hershëm të braktisjes shkollore.

24 *Një rast suksesi*

3. Sfidat më të madha që aktorët e shkollës hasën gjatë punës:

- Pranimi në shoqëri (jashtë klasës më shumë).
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me aktorët e tjerë jashtë shkollës.
- Ecuria gjatë procesit mësimor dhe mbështetja e tij me mësimin.
- Lufta e vazhdueshme për ta bërë të vërtetë dhe për ta pranuar moton “jam i ndyshëm, por i barabartë”.

4. Gjërat që aktorët e shkollës i kanë bërë mirë:

- Identifikimi i nevojave dhe dëshirave të tij.
- Puna e diferencuar e mësueses kujdestare për arritjet akademike.
- Komunikimi i vazhdueshëm me familjarët duke rritur tek ata ndjeshmërinë e lartë për shkollën dhe domosdoshmërinë e saj.
- Përfshirja në sa më shumë aktiviteteve sportive, rekreative dhe socio-emocionale.
- Nxitja e nxënësve të shkollës dhe komunitetit për t’i pranuar hapur rastet si Albani e për të zgjuar tek ata interesin e madh për arsimin.

5. Çfarë do të kishin bërë ndryshe?

- Në rrethana të tjera, identifikim i rastit mund të ishte bërë në një kohë më të hershme, në mënyrë që edhe ndërhyrja për të ndryshuar situatën të ishte në kohën e duhur.
- Shfrytëzimi maksimal i të gjitha hapësirave, mjediseve të shkollës për komunitetin. Vendosja e Albanit në rolin e liderit në këto aktivitet, në mënyrë që të nxitin e të krijojnë tek ai një “fushë” të re veprimi për të fituar vetëbesim.

6. Rekomandime për mësues të një shkolle tjetër, për të pasur parasysh kur adresojnë fëmijët në rrezik braktisje të shkollë:

- Të krijojnë sa më shumë ura komunikimi me familjarët dhe të gjithë kujdestarët e fëmijëve në rrezik braktisje.
- Të bashkëpunojnë me kolegët për të shkëmbyer eksperiencë dhe për të identifikuar nevojat e këtyre fëmijëve.
- Të nxitin sa më shumë te këta fëmijë afësitë e tyre në fusha të ndryshme. Të shfrytëzojnë anën e tyre pozitive dhe pikat e forta të fëmijës për të arritur sukses.

26 *Një rast suksesi*

- Të mbështesin nxënësit dhe të ofrojnë ndërhyrje sipas tre niveleve: 1) universal: për të gjithë nxënësit; 2) të targetuara: për një grup nxënësish; 3) individuale. Po ashtu të angazhohen për të krijuar ekipin e Paralajmërimit të Hershëm në shkollën e tyre duke u angazhuar në identifikimi e nevojave dhe hartimin e planeve individuale për të adresuar nevojat dhe problemet e nxënësit në rrezik braktisjeje
- Të kenë në punën e tyre gjithmonë moton “Kjo është sfida ime”. Kjo, me siguri, do t’u vlejë për ta çuar deri në fund rastin dhe për ta përdorur atë më pas si sukses.